



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prinljenor/Prodato Received/Delivrry	09.02.2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBAK	636/2022		1/1



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr. 1228/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari anëtar, me Ilire Mehmeti-Shaqiri, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr. 1228/2021 të datës 29.12.2021, të parashtruar nga ankuesi [adresa e banimit] përmes avokatit të autorizuar [Prishtinë], me adresë banim [Prishtinë], kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike 'Kërkese nga marrëdhënia a punës , duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim me datë 09.02.2022 , mori këtë;

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1228/2021 e datës 29.12.2021 e parashtruar nga ankuesi

MBETET në fuqi Vendimi nr. 273 datë 28.09.2010 i Komisionit Disiplinor të SHKK.

A r s y e t i m

Ankuesi [adresa e banimit] i punësuar sipas shkresave të lëndës në pozitën "Zyrtar i Lartë i Transportit" në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datën 24.08.2010 është njoftuar nga Burimet Njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës që me datë 27.08.2010 të merr pjesë në intervistën para Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës për shkelje të supozuar disiplinore (në lëndë nuk ka shkresë se nga kush është iniciuar procedura disiplinore)

Komisioni Disiplinore pas administrimit të provave me datë 28.09.2010 ka marr vendim me numër prot.273 me të cilin ankuesit \_\_\_\_\_ i shqipton masën disiplinore “Ulje në pozite”, me arsyetim se \_\_\_\_\_ ka qenë përgjegjës lidhur me lëndët në cilësinë e kryetarit të Komisionit vlerësueses për vlerësimin e ofertave për tenderin për “ Furnizimin e veturave për nevoja të DAP-it me ref.21500-10-001-121”, pasi që ankuesi në cilësinë e kryesuesit të komisionit vlerësueses e ka nënshkruar deklaratën me datë 28.05.2010 dhe formularin si të rregullt, pa qenë i rregullt pasi ka munguar katalogu i kompanisë por edhe formulari ka pasur mangësi për ta nënshkruar kontratën me kompaninë \_\_\_\_\_ me seli në Prishtinë.

Meqenëse në ndërkohë për këtë lëndë është ngritur procedurë penale në të cilën ankuesi ka qenë i përfshirë, Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda me datën 25.07.2019 ka marr aktgjykimin me numër PKR.nr.886/13 i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 27.02.2020 me të cilin ankuesin \_\_\_\_\_ : liron nga aktakuza.

Ankuesi \_\_\_\_\_ me datën 07.12.2021 ka parashtruar kërkesën me numër të protokollit 1342 në Ministrinë e Drejtësisë saktësisht tek Divizioni i Burimeve Njerëzore me pretendim që ti bëhet kompensimi i pagës- rimbursimi nga viti 2010 deri me tani.

Burimet Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës me datën 23.12.2021 i është përgjigjur ankuesit se kërkesa juaj refuzohet si e pabazuar dhe është jashtë afateve të parapara ligjore.

Ankuesi \_\_\_\_\_ kundër përgjigjes se datës 23.12.2021 të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës përmes avokatit \_\_\_\_\_ me autorizim me datën 29.12.2021 me ankesën me numër të protokollit 6377/2021 i është drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijen e Ankesave me datën 31.12.2021 ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 6458/2021 për përgjigje në ankesë, ndërsa me datën 14.01.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova:** Ankesën A.nr.1228/2021 të datës 29.12.2021 me numër të protokollit 6377/2021 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 29.12.2021; Përgjigjenin e datës 23.12.2021; Vendimin e datës 30.09.2010 me numër 02-962; Vendimin e datës 05.08.2011 me numër të protokollit 1363; Shkresën e datës 24.08.2010 me numër të protokollit 240 lidhur me thirrjen e komisionit disiplinore; Aktin e Emërimit të datës 05.03.2013; Kontratën e punësimit të datës 23.02.2010 me numër 46/DAQ; Vendimin e datës 28.09.2010 me numër të protokollit 237 të Komisionit Disiplinore të Ministrisë së Drejtësisë; Aktgjykimin me numër PKR.nr.886/13 të datës 27.02.2020 të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.12.2021 me numër të protokollit 6458/2021; Përgjigjenin në ankesë të datës 14.01.2021 me numër të protokollit 153/2022; Vendimin e datës 15.12.2009 me numër të protokollit 02-1682; Kërkesën e datës 07.12.2021 me numër të protokollit 1342 të parashtruar nga ankuesi në Divizionin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesi *është e pazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se Shërbimi Korrektues i Kosovës, nuk e ka marr për bazë Aktgjykimin e Gjykatës PKR.nr. 886/13 të Departamentit për Krime të Rënda, i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 27.02.2020.

Kolegji bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar se vendimi i Komisionit Disiplinor i datë 28.09.2010 nr. 273 në momentin e nxjerrjes nuk ka pasur parasysh asnjë element të procedurës penale, sepse procedura penale lidhur me këtë lëndë ka filluar në vitin 20013 sipas shenjës PKR.nr.886/13 prandaj Kolegji konstaton se Vendimi i Komisionit Disiplinor pavarësisht që ka lidhje me aktgjykimin në fjalë është zhvilluar në procedurë administrative duke respektuar të gjitha aktet ligjore në fuqi.

Kolegji duke u bazuar në shkresat e lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankuesi kundër Vendimit me Nr. 273 të datës 28.09.2010 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, nuk ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës ashtu siç përcaktohet në bazë të dispozitave të nenit 7 paragrafit 7.2 të Udhëzimit Administrativ Nr. MASHP/DASHC 2003/05 Procedurat e Ankesave i cili përcakton se: *"Ankesat duhet të paraqiten sa më shpejt pas ngjarjes me të cilën kanë lidhje. Në rastin e ankesës kundër selektimit, ngritjes në pozitë ose vendimeve të Komisionit disiplinor ankesat duhet të paraqiten brenda 30 ditëve"*.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Aktgjykimi PKR.nr.886/13 i Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Krime të Rënda është nxjerr më datë 22.05.2019, ndërsa me datën 27.02.2020 është bërë i plotfuqishëm, ndërsa ankuesi kërkesën për kthim në vendin e punës Zyrtar i Lartë i Transportit e ka parashtruar me datë 07.12.2021. që është në kundërshtim më dispozitat ligjore lidhur me afatin për paraqitjen e ankesë respektivisht Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës  
Lënda A.nr. 1228/2021**

*Ilire Mehmeti - Shaqiri*

*Procesmbajtëse*

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesi
- Përfaqësuesit Juridik avokatit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës ;
- Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

